

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34/2018 (JR)
Nr. 34/5 regj.

Tiranë, më 28.06.2019

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e **premtë, në datën 19.07.2019, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 34/2018, datë 13.11.2018, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Artur Malaj.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:


**Kryesuese e Trupit Gjykues
Relator i Çështjes
Gjyqtar
Gjyqtare
Gjyqtar**

**Rezarta Schuetz
Sokol Çomo
Ardian Hajdari
Ina Rama
Luan Daci**

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**RELATOR I ÇËSHTJES
GJYQTAR**

SOKOL ÇOMO



**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**

REZARTA SCHUETZ

